Përfshirja në strukturat lokale	8	Zyra Qendrore për Shkollimin Jashtë Vendit	22
Trualli për ndërtim	9	Legjenda	22
Tenderimi, dhënia e porosisë dhe fillimi i ndërtimit	9	Kontoja e donacioneve	23
Hapja	10	Informacionet aktuale i gjeni në faqen tonë të internetit:	
Përfundimi	10	www.alg-prizren.com	

Fëmijëve ju nevojitet ardhmëria

Krijimi

Fëmijët kanë nevojë për ardhmëri

Shpresat më të mëdha për Kosovën janë të drejtuara kah rinia e vendit. Më tepër se gjysma e popullsisë është më e re se 25 vjeç, njëra nga popullatat më të reja të Evropës. I tërë halli qëndron në atë që kjo gjeneratë nuk mund të rritet më tutje në një atmosferë të kufizimeve, ndarjeve, mërisë dhe perspektivës. Kjo rini ka nevojë për një shans të zhvillimit në frymën e mirëkuptimit, kujdesit dhe respektit.



Asaj i nevojitet mundësia për arsimim në kuptimin evropian. Vajzat dhe djemtë e të gjitha etnive dhe besimeve duhet të shkojnë së bashku në shkollë dhe të mësohen përsëri të jetojnë me njëri tjetrin.

Kërkesa qendrore në Konventën e UN mbi të drejtat e fëmijës së vitit 1989 është

që të gjithë fëmijët duhet të kenë një shkollim të mirë fillor (primary education) dhe qasje të barabartë në shkollimin e mëtejshëm (secondary education), sepse edukata dhe arsimi janë si themel për zhvillim, çelësi i të ardhmes.

Jean Monnet (1888 - 1979), një ideator dhe formulues i Evropës së bashkuar, pat thënë një herë: "Po të më duhej të filloja edhe një herë, unë me rastin e ndërtimit të Evropës më pak do kujdesesha për ekonominë, kurse shumë më tepër për kulturën dhe arsimin". Kosova si shtet demokratik evropian në botën islame ka të drejtë të pret nga Evropa angazhim të veçantë.



Me sa duket për këtë, në vjeshtën 2002 prindërit kosovarë iu drejtuan një bashkëpunëtorit të Renovabit dhe e lutën për themelimin e një gjimnazi klasik në Kosovë.

Themelimi i një gjimnazi klasik

Ideja

Themelimi i një gjimnazi klasik me një konvikt për vajza dhe një konvikt për djem.

Qysh në pranverën e 2003 Renovabis-i dërgoi atë Happel SJ në Kosovë dhe e ngarkoi atë me një studim të realizueshmërisë në lidhje me: Mundësinë e themelimit të një gjimnazi klasik në Kosovë? Në fund të qershorit u paraqiten rezultatet. Themelimi i një gjimnazi klasik në Kosovë jo vetëm që është i dëshirueshëm dhe i realizueshëm por edhe me përgjegjësi. Veçanërisht duhet t'i përkushtohet kujdes arsimit të vajzave dhe atyre t'iu ipet shansi për një arsimim të mirë.

Gjimnazi që do të themelohej do të duhet të jetë patjetër gjimnaz me konvikt, i cili do të jetë i hapur për të gjitha vajzat dhe djemtë nga Kosova dhe vendet për rreth.

Ideja shndërrohet në projekt

Në vjeshtë 2003 Renovabis-i ngarkon Krahinën e Jezuitëve me realizimin e projektit dhe njëkohësisht premton një financim madhështor shtytës, si dhe marrjen përsipër të një pjese të

Prizren është kryeqyteti historik

madhe të shpenzimeve të ndërtimit.

Atë Happel SJ u ngarkua me këtë dhe u dërgua në Kosovë

Prizreni si vendndodhje

Prizreni është kryeqyteti historik i Kosovës dhe deri sot qendra religjioze e katolikëve, myslimanëve dhe të krishterëve serbo-ortodoks në Kosovë. Shumë shpesh diskutohet për zhvendosjen e funksioneve të kryeqytetit nga Prishtina në



Asociation "Loyola-Gymnasium"

P. Happel SJ filloi punën e vet në Prizren

Prizren. Përveç kësaj Prizreni është qytet i ngritur në qendër, në të cilin një gjimnaz klasik do të kishte një vlerë të lartë simbolike dhe do të rriste më tutje rëndësinë e komunës. Prizreni shtrihet në "sektorin gjerman" të KFOR-it¹ dhe vlerësohet si qyteti më i sigurt i Kosovës.

Ushtria federale (Bundeswehr) dhe gjermanët këtu gëzojnë një renome të mirë. Në Prizren mund të arrihet shpejt nga Maqedonia dhe Shqipëria. Gjimnazi me konviktet e veta kështu është i hapur edhe për vajzat dhe djemtë edhe nga këto vende.

Përfshirja në strukturat vendore

Atë Happel SJ filloi punën e tij në Prizren së pari duke vënë kontakte me të gjitha organizatat e rëndësishme.

Ai bisedoi me përfaqësuesit e autoriteteve vendore, të UNMIK-ut², të KFOR-it¹ dhe të CIMIC-ut³, u këshillua me KTA-në⁴ dhe NGO-të⁵ tjera që punonin në Kosovë.

Ai negocioi me administratën e qytetit të Prizrenit dhe mi-

Vënia e kontakteve

nistrinë kompetente në Prishtinë. Jo së fundi ai projektin ia prezantoi edhe Administraturës Apostolike në Prizren.

Nga të gjitha anët ai mësoi jo vetëm për dashamirësinë e madhe, por edhe për ndihmat konkrete sipas mundësive të secilit nga bashkëbiseduesit e tij. Hap pas hapi janë tejkaluar pengesat formale dhe burokratike dhe te organizatat pjesëmarrëse u krijua një ndjenjë për projekt të përbashkët.

Si person juridik, që vepron në Kosovë, në dhjetor të 2003 është themeluar Asociation "Loyola-Gymnasium" (akronimi:



Trualli për ndërtim – 3,8 ha

ALG) si Shoqëri bartëse për gjimnazin dhe konviktet.

Trualli për ndërtim

Trualli për ndërtim, prej afro 3,8 ha, shtrihet në periferinë veriperëndimore të qytetit të Prizreni drejtpërsëdrejti në Rrugën e Transisit për Shqipëri, është dhënë në dispozicion nga qyteti i Prizrenit.

Me certifikatën e datës 11 maj 2005, UNMIK-u ia ka bartë tru-



Fillimi i ndërtimit 16 prill 2005

allin ALG-së për 99 vjet. Regjistrimi në librin kadastral pason më 15 qershor 2005.

Tenderimi, dhënia e porosisë dhe fillimi i ndërtimit

Në janar 2005 pason hapja e tenderit për planin e ndërtimit. Në afatin e dhënë 11 të interesuar morën dokumentacionin e tenderit.

Në ditën e hapjes së ofertave kishte katër oferta. Një komision pesë anëtarësh i shqyrtoi ofertat. Si fitues u zgjodh firma Global nga Prizreni.

Më 24 mars 2005 u bë nënshkrimi i kontratës për ndërtim me firmën Global dhe veç më 16 prill 2005 bëhet vënia solemne e gurëthemelit.



Asociation "Loyola-Gymnasium"

Vetëm 5 muaj më vonë inaugu-
rimi dhe fillimi i mësimit



Hapja

Vetëm 5 muaj më vonë, më 12 shtator 2005, pjesë të shkollës dhe konvikteve u hapën solemnisht. Mësimi për 184 fëmijë filloi në ditën e nesërme. Kjo ishte e mundur vetëm me punën e pa ndërprerë të ndërtimit dhe me përkushtim të angazhuar të të gjithë pjesëmarrësve. Kohë pas kohe kishte edhe 200 punëtorë ndërtimi të punësuar në kantier. Organizata gjermane për ndihmë teknike (THW) bënte mbikëqyrjen e punimeve. Renovabis bartëte pjesën më të madhe të shpen-

Përfundimi më 16 prill 2007

zimeve për pjesën e parë të ndërtimit.

Përfundimi

Më 16 prill 2007, në dyvjetorin e vënies së gurëthemelit, kremtuam përfundimin e të gjitha punimeve ndërtimore. Vlen të theksohet se janë përmbyshur sikur afatet kohore ashtu edhe marrëveshjet financiare. Shpenzime më të mëdha u paraqiten vetëm atje ku janë ndërmarrë ndryshime në realizim ose vëllim, si për shembull, në fushat e sportit. Nga terreni



Asociation "Loyola-Gymnasium"

sportiv i planifikuar me shtresën e ziftit dolën 3 terrene sportive me shtresë prej granulatit të gomës.

Për përkrahjen tanimë të dëshmuar dhe sigurisht akoma shpesh të nevojshme në të ardhmen, lë t'i falënderojmë nga ky vend me gjithë zemër të gjithë pjesëmarrësve!

Shoqëria bartëse - ALG

Asociation "Loyola-Gymnasium" - bartës i përgjeshëm juridik

Projekti ishte dhe është i pa imagjinueshëm në Kosovë pa një person juridik. Personi juridik shërben si partner bisedimi për të gjitha organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare dhe funksionon si bartës për Gjimnazin dhe konviktet.

Me emrin Asociation "Loyola-Gymnasium" (ALG) është formuar Shoqëria bartëse në dhjetor 2003 në Prishtinë dhe veç më 19 janar 2004 është regjistruar te UNMIK-u si NGO (Organizatë joqeveritare).

Më 8 shkurt 2005 Shoqërisë bartëse i është njohur statusi i

Bartësi përgjegjës juridik



interesit të përgjithshëm (Public Benefit Status) nga Ministria për Punë Publike.

Qëllimi i Shoqërisë është përparimi i edukimit klasik dhe arsimit në Kosovë dhe me këtë përkrahja e njerëzve të rinj.

Këtu përfshihet edhe përgatitja e rinisë së Kosovës për konkurrencë në Evropë dhe integrimin e saj përkatës në lëmin e arsimit dhe shkencës, si dhe përkrahjen e një dijeje që i

Asociation "Loyola-Gymnasium"

Më 16 maj 2004 në Kuvendin e Qytetit të Prizrenit

përgjigjet moshës nga kultura, shkenca dhe arti.

Seanca konstituive e Shoqërisë bartëse - ALG

Më 18 maj 2004 në Kuvendin e Qytetit në Prizren u mbajt seanca konstituive e Shoqërisë bartëse. Për mënyrat e veprimit të mëtejme në procesverbal thuhet:

"Anëtarët ishin unik që me mbështetjen e projektit të fillohet



qysh në këtë vit. Pasi që për shkaqe kohore (përfundimi i shpejtë i vitit shkollor, zgjedhja e mësuesve, arsimimi dhe perfeksionimi i mësuesve, lokalet provizore për mbajtjen e mësimet) fillimi i mësimet nuk do të mund të realizohet në vitin a ardhshëm shkollor (shtator 2004), anëtarët kanë vendosur që të ndërmarrin çdo gjë, që të mund të fillohet me ndërtim qysh në këtë vit shkollor (2004/05). Gjithashtu do të duhet sa më shpejtë që është e mundur të bëhet zgjedhja dhe trajnimi i mësuesve dhe të përpunohet programi pedagogjik".

Anëtarët aktualë në Shoqërinë bartëse:

- Albanian Youth Action
- Administratura Apostolike Prizren
- Krahina Gjermane e Jezuitëve
- Françeskanet nga Cetina
- Freunde und Förderer der Asociation "Loyola-Gymnasium" e.V.
- Grünhelme e.V.
- Kosova Alternative Education



Të dëshiruar janë anëtarë tjerë

- Krahina Kroate e Jezuitëve
- Marianne und Rudolf Haver Stiftung
- Provinca Austriake e shoqërisë së Jezuitëve
- Stellaner-Vereinigung Deutschland e.V.

Anëtarët tjerë janë të dëshiruar!
Personat juridikë janë të ftuar të bëjnë kërkesë.

Statistikë Nxënësit, të punësuarit

Tabela 1 paraqet një pasqyrë për zhvillimin e numrit të nxënësve dhe të numrit të punësuarve në Loyola-Gymnasium.

Spikatët në të dy lëmitë numri relativisht i lartë i katolikëve. Në popullsinë e përgjithshme të Kosovës, katolikët janë një pakicë absolute prej afro 3%. Ne i gëzohemi edhe pjesëmarrjes së lartë të vajzave dhe bashkëpunëtorëve.

Tabela 1 Nxënës dhe të zënë me punë

Tabela 1

Viti shkollor	2005/06			2006/07			2007/08			2008/09		
	Σ	♀	♂	Σ	♀	♂	Σ	♀	♂	Σ	♀	♂
Nxënësit												
- jo konviktorë	136	61	75	237	102	135	377	164	213	408	191	217
- konviktorë	29	10	19	81	27	54	122	45	77	153	68	85
Gjithsej	165	71	94	318	129	189	499	209	290	561	259	302
Punësuarit												
- Mësues	13	4	9	21	6	15	30	12	18	35	13	22
- Edukatorë	5	3	2	6	5	1	7	4	3	9	5	4
- Kuzhinierë	1		1	1		1	2	1	1	2	1	1
- Portierë	1		1	1		1	2		2	2		2
- Administratë	3	2	1	3	2	1	2,5	1,5	1	2,5	1,5	1
- Drejtori	2		2	2		2	2		2	2		2
Gjithsej	25	9	16	34	13	21	45,5	18,5	27	53,5	19,5	31

Administrata jonë akoma është shumë "e hollë", për çfarë do të kihet kujdes edhe në të ardhmen.

Pedagogjia ignacioniste

Përmbajtjet pedagogjike

Ne ndjehemi të obliguar ndaj pedagogjisë ignacioniste.

Ne, pra, i përmbahemi një pedagogji optimiste. Edukimi ynë pranon botën dhe jetën si të tilla dhe dëshiron të kontribuojë në edukimin e plotë të individëve në bashkësi, të përkrahë dialogun.

Në bazë të qëndrimit të saj pozitiv ndaj botës pedagogjia



Dija nuk është arsim

jonë vlerëson që çdo gjë duhet të hulumtohet. Nxënësit tanë parimisht duhet të jenë të hapur dhe të gatshëm për sukses ndaj të gjitha pyetjeve dhe qarqeve të problemeve – dhe atë jo vetëm paradite në shkollë. Bartja e thjeshtë e dijës dhe aftësive funksionale akoma nuk paraqet arsimim të plotë.

Edukata pa vlera nuk mjafton. Për këtë përkrahja e personave individuale shihet si nga qëllimet më të rëndësishme të një edukimi shkollor, si dhe një arsimim i përgjithshëm i argumentuar.

- Ne mbështesim vlerat e trajtimit individual dhe kujdesit për secilin nxënës individualisht.
- Ne theksojmë iniciativën

Zërat e nxënësve



Loyola-Gymnasium është një nga shkollat më të mira në Kosovë. Është mrekulli të jesh pjesë e

kësaj shkolle. Është një shkollë që ka shumë për të ofruar, por edhe kërkon shumë. Këtu mund të jesh në elementin tënd. Këtu mund ti realizosh ëndrrat tua. Ajo të jep shansin që nga vetja të bësh diçka. Për mua personalisht vendimi për të ardhur këtu, ka qenë më i miri në jetën time. Kjo është diçka për të cilin unë nuk do të pendohem kurrë. Unë këtu kam mësuar shumë, kam krijuar një rreth shokësh dhe kam mësuar të jem e mëvetësishme.

Gjerolinda Desku - XI a

Gjuhët Shqip & Gjermanisht

individuale dhe i përmbahemi asaj, se duhet të mësohet gjatë tërë jetës.

- Ne orientohe mi në vlera, trimërojmë për njohje, për dashuri dhe për pranimin e vetës sonë.
- Ne dëshirojmë të kontribuojmë për njohje reale të botës dhe organizimit të saj.
- Ne kemi synime të jashtëzakonshme, për të përkrahur zhvillimin mundësisht sa më të përsosur i të gjitha prirjeve të personit.



Jeta në konvikt është një jetë e veçantë. Unë jam më e pavarur dhe jam e rrethuar me njerëz të cilët janë si unë, të cilët më

kuptojnë dhe kanë synimet dhe qëndrimet e njëjta. Ne jemi bërë një familje e madhe.

Një familje e lumtur.

Donika Hajdaraj - VII a

Zërat e nxënësve

Latinisht & Anglisht

Aspekte të rëndësishme të edukimit të personalitetit kanë të bëjnë me zhvillimin e aftësive sociale, si aftësia për kritikë, sensibilitet dhe kreativitet, por para së gjithash respekt ndaj të tjerëve dhe aftësi për dashamirësi njerëzore.

Këtu qëndron shansi i veçantë i shkollës me konvikt, siç është Loyola-Gymnasium në Prizren: gërshetimi i jetës dhe mësimi, i mësimdhënies dhe kohës së lirë, mundësojnë një edukatë dhe arsimim të mirë. Këtu mund të mësohen dhe ushtrohen sjelljet sociale, shoqërore dhe të bashkësisë. Kështu ndodh edukimi në grupet konviktore, i cili i është përshtatur secilës



Bartja e vlerave në Loyola-Gymnasium në Prizren, bëhet në një rën anë përmes edukatorëve dhe mësuesve të zgjedhur me kujdes dhe shëmbëlltyrës së tyre në jetën e përditshme që u japin nxënësve.

Në anën tjetër përmes mësimdhënies në të gjitha lëndët, veçanërisht në lëndët e përshtatshme për këtë.

Asociation "Loyola-Gymnasium"

Mësimi dhe jeta në një bashkësi

Zërat e nxënësve



Unë gjithëherë kam ëndërruar të vijoj një shkollë siç është Loyola-Gymnasium dhe që të kem një rreth shokësh të mirë. Pastërtia, e cila sundon këtu në Gjimnaz, më pëlqen shumë. Unë nuk do të besoja, se një shkollë këtu në Kosovë mund të jetë kaq e pastër.

Mua më pëlqen viti i ri shkollor (i dyti për mua) shumë më tepër, sepse kanë ardhur shumë nxënës të ri. Unë kam njohur shokë të ri. Përveç kësaj, ne kemi edhe një edukator të ri në konvikt.

Për fund dëshiroj të them, që nxënësit dhe nxënëset në Loyola-Gymnasium po ndjekin rrugë të drejtë për një arsim të mirë, i cili është shans i madh për një të ardhme më të mirë.

Hysen Hoti - VII a

moshë dhe është organizuar në mënyrën që i përgjigjet njohurive të pedagogjisë moderne. Ne jemi të bindur në atë, që pasuria e mendimit evropian, paraqet fundament adekuat, në bazë të të cilit dija shpie në arsimim.

Edhe pse jeta dhe mësimi në bashkësi i lehtëson disa gjëra, nuk ka edukim pa mund. Shkolla jonë është institucion edukativ që përgatitë fëmijët për jetën e tyre të ardhshme dhe që kërkon angazhim të qenësishëm personal.

Edukimi në Loyola-Gymnasium ndërlihd

Shkollë partnere e Republikës Federale të Gjermanisë

shumëfish atë të dëshmuarën me kërkesat e reja. Edukimi në Loyola-Gymnasium për këtë përfshinë të mësuarit e gjuhës latine, gjermane dhe angleze, sikurse edhe të mësuarit në lëmit e shkencave moderne natyrore.

Dija e fituar dhe talentet nuk duhet t'i shërbejnë plotësisht egoist të nevojave personale, por duhet që çdo herë të angazhohen edhe për të mirën e shoqërisë. Për këtë arsye edukimi në Loyola-Gymnasium në Prizren është i lidhur ngushtë me shoqërinë. Ai kuptohet si një pjesë e idesë evropiane dhe dëshiron të zgjojë kërkesën për një drejtësi sociale. Ky



Gatishmëria për dije Aftësia për punë Gatishmëria për punë



angazhim duhet të udhëzojë drejtë një shërbimi të shquar për të tjerët dhe për marrjen e pozicioneve me përgjegjësi në shoqëri.

Njerëzit janë individë me dhunti dhe mundësi të ndryshme.

Për këtë ne nuk guxojmë që ndaj secili të përdorim kritere të njëjta në kuptimin

e një gare për sukses. Por secili nxënës duhet të provojë, që talentet dhe aftësitë e veta ti zhvillojë më së miri brenda mundësive ekzistuese.

Vetëdije, aftësi për punë dhe gatishmëri për punë ne kërkojmë në mënyrë të njëjtë jo vetëm nga nxënësit, mësuesit dhe edukatorët, por edhe nga prindërit dhe natyrisht edhe nga vet ne. Pedagogjia jonë ngritët mbi bashkëpunimin e përhershëm dhe me plot besim të prindërve, mësuesve, edukatorëve dhe nxënësve.

Diploma e gjuhës e Konferencës Gjermane të Ministrive të Kulturës

Kjo kërkon:

- Një këmbim të dendur të informatave dhe mendimeve.
- Gatishmëri për mësim në anën e nxënësve, prindërve, mësuesve dhe edukatorëve.
- Bashkëpunim nga ekipi udhëheqës (drejtori, drejtori i shkollës, drejtori i konviktit), konferenca e mësuesve dhe edukatorëve, përfaqësuesit e prindërve dhe nxënësve.
- Përgjegjësinë

Zërat e nxënësve



Mua më pëlqen jeta në konvikt shumë: së pari, sepse e tërë rrjedha e ditës është e planifikuar dhe ne të shumtën i e rasteve i përmbahemi këtij plani. Së dyti, sepse këtu jetoj së bashku me shokë. Ne kemi shumë argëtim dhe tërë kohën e kalojmë bashkërisht, pa marrë parasysh se a mësojmë, i kryejmë detyrat e shtëpisë, merremi me sport, apo jemi duke ngrënë, ne i bëjmë të gjitha së bashku.

Ajo që mua nuk më pëlqen aq mirë në konvikt, janë tërë ato rregulla (për çdo intësi), të cilave duhet t'u përmbahemi. Por siç thotë një fjalë e urtë: "Rregullat janë, për të mos iu përmbajtur". Këtë edhe ne e bëjmë nga njëherë, të shumtën jo qëllimisht dhe te ato rregullat jo aq të rrepta siç është qitja e bërllokut jashtë, pastrimi i dhomave tona, etj.

Por mendoj se jetën këtu në konvikt kjo e bën shumë më interesante dhe më emocionuese.

Unë jam thjeshtë, i lumtur që jam këtu

Blend Arllati - XII b

Asociation "Loyola-Gymnasium"

Bartja e vlerave

Zërat e nxënësve



Këtë vit konvikti është bërë më i mirë dhe kanë ardhur më shumë nxënës.

Vitin e fundit ishim vetë më pak, kurse tash gati i tërë konvikti po shfrytëzohet. Ne e kemi edhe një edukator të ri dhe shumë mësues të ri.

Ne tani në shkollë mund ta shfrytëzojmë edhe laboratorin e kimisë dhe të mësojmë më tepër praktikë. Kështu orët e mësimt janë më interesante dhe po na motivojnë, të mësojmë më tepër. Unë besoj, se ky vit do të jetë një vit i mirë shkollor.

Erzen Duraku - X b

duhet ta kenë të gjithë pjesëmarrësit në procesin edukativ dhe vetë procesi duhet të kontrollohet përherë.

Kështu Loyola-Gymnasium me konviktet e veta nuk dëshiron që nxënëset dhe nxënësit vetëm t'i përcjellë deri në përfundim të mirë të shkollës, por që ata t'i formojë si persona-



litete, të cilët, të ndikuar nga vlerat dhe qëllimet evropiane, ta organizojnë jetën në këtë botë dhe shoqëri të vetëdijshëm dhe të përgjegjshëm si "njerëz për të tjerët".



Mua personalisht më pëlqen jeta në konvikti. Në fillim mezi ia dilja të mësohem me këtë, por me kalimin e kohës kjo gjithëherë bëhej më e lehtë.

Tani kam shumë shokë dhe do të jem shumë i mërzhitur, kur në fund të vitit shkollor do të duhet të ndahem prej tyre.

Rajmond Nue - XII b



Tabela 2 Plani i orëve

Tabela 2

	VI			VII			VIII		IX		X					XI			XII			Σ
	a	b	c	a	b	c	a	b	a	b	a	b	c	d	e	a	b	c	a	b	c	
Gjuhë shqipe	5	5	6	4	4	4	4	4	4	4	6	6	6	6	7	5	5	5	5	5	5	105
Gjuhë latine	5	5	5	4	4	4	4	4	4	4	2	2	2	2	1				1	1	1	55
Gjuhë gjermane	5	5	5	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	3	3	3	3	3	3	4	3	80*
Gjuhë angleze	2	2	2	2	2	2	3	3	3	3	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	4	68
Histori	2	2	2	2	2	2	1	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	40
Njohuri shoqërie				1	1	1	1	1	1	1	2	2	2	2	2							17
Gjeografi/Ekonomi	2	2	2	2	2	2	1	1	1	1						2	2	2	2	2	2	28
Matematikë	4	4	5	4	4	4	4	4	3	3	4	4	4	4	5	3	3	3	3	3	3	78
Fizikë				2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	36
Kimi				1	1	1	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	33
Biologji	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	42
Art figurativ	1	1	1	2	2	2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	24
Muzikë	2	2	2	1	1	1	2	2	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	26
Sport	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	2	42
Informatikë							1	1	2	2	1	1	1	1	1	2	2	2	2	2	2	23
Psikologji																1	1	1	1	1	1	6
Sociologji																1	1	1	1	1	1	6
Filozofi																1	1	1	1	1	1	6
Lëndët e zgjedhura																						
Σ	32	32	34	33	33	33	34	34	34	34	35	35	35	34	35	34	34	34	35	36	35	635

Plani i orëve

* 24 orë shtesë mësim përforcues
3. Februar 2009

Arsimi kushton

Kriteret e pranimit, tarifat dhe shpenzimet

Gjysma e vendeve në shkollë dhe në konvikte është i rezervuar për vajzat. Kushti i vetëm për pranim është dhënia e provimit pranues.

Me tarifat tona ne orientohe mi në tarifat për institucionet publike, p.sh. për kopshtet e fëmijëve. Nga janari 2009



Zërat e nxënësve



Sivjet më pëlqen gjithçka më mirë. Jeta në konvikt gjithashtu është më interesante se viteve të fundit.

Edhe në shkollë është gjithçka më interesant. Nga njëra anë, lëndët e mësimit nga shkencat natyrore janë bërë më interesante duke i falënderuar kabinetit shkencor, në anën tjetër do të pritet shumë më tepër rreptësi, për të marr nota të mira.

Arjan Bala - X a

Bursa për nevojtarët

vlejné këto tarifa:

Pagesa për shkollë 70 EUR/muaj = 840 EUR/vit
Pagesa e konviktit 150 EUR/muaj = 1.800 EUR/vit
(duke shtuar dhe pagesën për shkollim)

Për familjet me nevojë sociale ne ndajmë bursa. Kriteret për dhënie janë nevojat sociale dhe suksesi i qëndrueshëm i mirë shkollor.

Përveç kësaj, faktikisht të gjithë fëmijët tanë marrin një bursë, pasi që tarifat e përmendura mbulojnë vetëm afro 50 % të koston rrjedhëse.

Kështu buxheti për vitin shkollor 2008/09 kap shumë prej afro 1.252.500,00 EUR. Nga tarifat pritët të mblidhen vetëm afro 600.000 EUR.

Zërat e nxënësve



Në fillim ishte e tëra shumë vështirë. Përshtatja në kushtet e konviktit, njerëzve të ri, në shkollë.

Por unë e përballova, sepse unë dëshiroja të bëhem e pavarur. Tani nuk po pendohem që kam ardhur në këtë shkollë.

Unë kam zhvilluar karakterin tim dhe kam mësuar, të synoj ëndrrat e mija.

Teuta Mataj - XI a

Mirënjohje miqëve tanë



Mirënjohje

Arsimi nuk merret falas. Sikurse çdo institucion tjetër arsimor edhe Loyola-Gymnasium ka nevojë për subvencione financiare. Ekzistimi i tij i mëtejme mund të sigurohet vetëm nëse ne edhe në të ardhmen do të jemi të përkrahur nga miqtë, përkrahësit dhe mirëdashësit tanë.

Në mesin e tyre janë përveç personave të shumtë edhe firmat private, fondacionet, autoritetet dhe korporatat e të drejtës publike, nga të cilat disa për shkak të modestisë nuk duan të përmenden.

Për të evituar, që mos ta hidhërojmë ndokënd, të cilin pa dashje nuk do ta kishim përmendur, ose për dikë do ta përmendnim gabimisht, edhe pse ai nuk do të dëshironte të përmendej, kemi vendosur:



Ne i falënderojmë të gjithë përkrahësit tonë nga gjithë zemra, por asnjërin nga ata nuk do ta përmendim me emër.

Për këtë flasin edhe përvojat e keqpërdorimit të të dhënave të tilla, të cilat mjerisht edhe janë bërë.

Zërat e nxënësve



Unë kurrë nuk do të mendoja, se jeta në konvikt është kaq e mrekullueshme. Një vend i ri, me shokë të ri.

Ishte vështirë të ndahesha nga familja ime, por mua më pranuan përzemërsisht, në të ashtuquajturën familje të re.

Tani jam përshtatur në konvikt dhe mësuar me shkollën. Tani më mbetet vetëm të punoj, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të arrij diçka në jetën time.

Florina Pnishi - X e

Asociation "Loyola-Gymnasium"

Gjermanisht si gjuhë e huaj

Zyra Qendrore për Shkollim Jashtë Vëndit

Loyola-Gymnasium trajtohet nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Zyra Qendrore për Shkollim Jashtë si projekt fener dhe për shkak të aftësive të tija të punës përkrahet në mënyrë të veçant me personel dhe materialisht.



Tri forca mësimore nga Republika Federale japin mësim këtu, më tepër se kaq, edhe këshilltari profesional dhe koordinatori i programit të detashimit të mësuesve, e ka selinë e vetë zyrtare në Loyola-Gymnasium. Si shkolla e vetme në vend, Loyola-Gymnasium është "Shkollë partner e Republikës Federale të Gjermanisë":

Pas një verifikimi shumë të përpiktë dhe të hollësishtëm shkolla ka të drejtë të realizojë provimet për Diplomën e gjuhës gjermane të Konferencës së Ministrive të Kulturës për të gjitha nivelet të kornizave evropiane të referencës. Me nivelin më të lartë të mundshëm C 1 në aspektin gjuhësor është e lidhur e drejta e nxënësve të huaj të studiojnë në cilindo universitet gjerman.

1,2,3,4,5

Legjenda

- KFOR - KOSOVO FORCE** - Formacioni multinacional ushtarak i formuar nga NATO pas mbarimit të Luftës në Kosovë në vitin.
- UNMIK - UNITED NATIONS INTERIM ADMINISTRATION MISSION IN KOSOVO** - Është formuar nga Këshilli i Sigurimit më 10. 06.1999 (Rezoluta 1244) si Mision pagësor i OKB për rimëkëmbje dhe rindërtim të Kosovës.
- CIMIC - CIVIL MILITARY CO-OPERATION** - Pjesë përbërëse e udhëheqjes ushtarake të KFOR-it gjerman..
- KTA - KOSOVA TRUST AGENCY** - Agjensioni Kosovar i Mirëbesimit (UNMIK-Rezoluta 2002/12 - 13.06.2002).
- NGO - NON-GOVERMENTAL ORGANIZATION** - Organizatë jo shtetërore, e cila nuk është e orientuar në fitim dhe as nuk organizohet prej institucioneve shtetërore dhe nuk është e varur prej tyre.

Zërat e nxënësve



Më ëndje e kujtoj ditën e parë në Loyola-Gymnasium. Oborri i shkollës ishte plotë me nxënës dhe

nxënësve, të cilët takoheshin për herë të parë. Të jem e sigurtë, shkolla ma përkujton një aeroport, ku shumë njerëz ndaheshin dhe takoheshin përsëri.

Sot kam lidhur shumë shokë qerri dhe po shfrytëzoj jetën në Loyola-Gymnasium.

Biondina Shehu - X e